

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7827
E premte, 5 korrik 2024
Çmimi 0.50

Hamza në Prizren:
PDK-ja, e gatshme
për zgjedhje të reja



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja FESTON 248-VJETORIN E PAVARËSISË, KOSOVA E URON DHE KUJTON ALEANCËN E FUQISHME ME TË



Me rastin e kësaj dite, togu ceremonial i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka ngritur të enjten flamurin amerikan në

Prishtinë të shtatorja e ish-presidentit amerikan Bill Clinton, ndërkaq liderët shtetërorë të Kosovës dhe ata të

opozitës e kanë urrear ShBA-në, duke theksuar se si popull dhe si shtet mbesin përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**HOVENIERI: PRESIM
NGA KOSOVA DHE
SERBIA T'I ZBATOJNË
PA PARAKUSHTE
DHE URGJENTISHT
OBLIGIMET NGA
DIALOGU**



**ALBERT
ZOGAJ
RIZGJEDHET
KRYESUES I
KGJK-SË
EDHE PËR
NJË MANDAT**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



**'EURO 2024', SONTE SUPERNDESHJET
SPANJË - GJERMANI DHE
PORTUGALI - FRANCË**

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hezbollahu i hedh mbi 200 raketa në Izrael pas vrasjes së një komandanti

MEJULLA, 4 KORRIK - Grupi libanez Hezbollah thotë se i ka hedhur mbi 200 raketa në drejtim të disa bazave ushtarake në Izrael si përgjigje për një sulm ajror izraelit që la të vdekur njërin prej komandantëve të lartë të grupit. Sulmi nga grupi militant i mbështetur nga Irani të enjten ishte ndër më të mëdhenjtë në konfliktin disamujor përgjatë kufirit në mes të Libanit dhe Izraelit.

Ushtria izraelite tha se “predha të shumta dhe objektiva të dyshimta ajrore” u futën në territorin e tij nga Libani, shumica prej të cilave u parandaluan. Nuk u raportua për viktima.

Rreth 160 “predha” u shkrepen në drejtim të Lartësive të uzurpuara të Golanit dhe rreth 15 dronë u hodhën brenda territorit izraelit, disa prej të cilëve u parandaluan, tha ushtria izraelite.

Të mërkurën Izraeli e pranoi se vrau një ditë më parë Mohammad Naamhe Nasserin, i cili ishte

udhëheqës i njërit prej tri divizioneve rajonale të Hezbollahut në jug të Libanit. Pak orë pas vrasjes së tij, Hezbollahu hodhi raketa të shumta të llojeve, Katyusha dhe Falaq, në veri të Izraelit, si dhe në Lartësitë e uzurpuara të Golanit. Të enjten ky grup shkrepri edhe më shumë raketa dhe tha se lëshoi edhe dronë kamikazë në drejtim të disa bazave.

Nasseri ishte shumë i rëndësishëm për Hezbollahun, pasi mori pjesë në beteja të kaluara në konfliktet në Siri dhe Irak nga viti 2011 deri në vitin 2016, si dhe luftoi në luftën e fundit të grupit kundër Izraelit më 2006.

Hezbollahu nisi sulme raketore në veri të Izraelit një ditë pasi Hamasi e kreu një sulm befasues në jug të Izraelit më 7 tetor, duke nxitur luftime të kufizuara përgjatë kufirit të tensionuar. Por, prej atëherë, sulmet janë përshkallëzuar dalëngadalë, me Hezbollahun që vuri në përdorin armë të reja për të



kryer sulme dhe me Izraelin që goditi më thellë Libanit. Hezbollahu ngul këmbë se nuk do t'i ndalë sulmet derisa të arrihet marrëveshje për armëpushim në Rripin e Gazës. Zyrtarët izraelitë kanë kërcënuar se do të kryejnë operacion më të

madh ushtarak nëse Hezbollahu nuk i ndal sulmet. Mbi 450 njerëz janë vrarë nga sulmet ajrore izraelite në Liban prej tetorit, shumica e të cilëve luftëtarë të Hezbollahut, por aty përfshihen edhe më shumë se 80 civilë dhe joluftëtarë.

Nga pala izraelite, 16 ushtarë dhe 11 civilë janë vrarë prej se nisi lufta në Gazë. Dhjetëra mijëra njerëz nga të dyja anët e kufirit të tensionuar janë shpërngulur si pasojë e luftimeve. Më 2006 Izraeli dhe Hezbollahu bënë një luftë disamujore, e cila mbaroi me barazim.

Bjellorusia pranohet në SCO në ditën e fundit të samtit të grupimit rajonal në Astana

Liderët e Kinës, të Rusisë, të Turqisë, të Pakistanit, të katër prej pesë ish-republikave sovjetike nga Azia Qendrore, si dhe liderë të tjerë shtetërorë, e vazhduan të enjten në Kazakistan samitin dyditor të Organizatës së Shangait për Bashkëpunim (SCO).

SCO-ja është një grupim rajonal i promovuar nga Pekini dhe Moskë si alternativë ndaj ndikimit të Perëndimit.

Liderët e nisën ditën e dytë dhe të fundit të samitit duke e pranuar Bjellorusinë anëtare të re. Ky vendim ishte i prishëm dhe e avancon liderin autoritar Alyksandr Lukashenka në rrugën e tij antiperëndimore pas zgjedhjeve të kontestuara para katër vjetëve, të cilat nxitën protesta të papara rrugore dhe një luftë brutale ndaj tyre.

Lukashenka synoi anëtarësimin e Bjellorusisë në SCO për më shumë se një dekadë.

Në tri vitet e fundit vendimet e tij për t'i “armatosur” emigrantët nga



vendet e treta në kufirin e Bjellorusisë me fqinjët e saj nga Bashkimi Evropian dhe për t'i lejuar trupat ruse ta kryejnë pushtimin e plotë të Ukrainës nga territori bjellorus, e kanë larguar edhe më shumë Lukashenkan nga Perëndimi dhe e ka rritur varësinë e tij në Moskën.

Lukashenka e quajti “historik” anëtarësimin e Bjellorusisë në SCO. Ai theksoi nevojën “për ta shkatërruar botën njëpolare” dhe për ta marrë përsipër përgjegjësinë për “sigurinë globale”, sepse “Perëndimi narcisist dhe vetjak është dëshmuar i paaftë për këtë”. Analistët kanë thënë se Lukashenka

do të shpresoje se anëtarësimi në SCO do ta rrisë dhe zgjerojë bashkëpunimin shumë të nevojshëm tregtar dhe ekonomik të Bjellorusisë me Kinën, duke e ulur varësinë e regjimit të tij në Moskën. SCO-ja është organizatë politike, ekonomike, e mbrojtjes dhe sigurisë, e themeluar nga Kina dhe

Rusia më 2001. Me pranimin e Bjellorusisë, ajo tani ka 10 vende anëtare, përfshirë Indinë dhe Pakistanin, që iu bashkuan më 2017, dhe Iranin, që u anëtarësua më 2023.

Katër nga pesë ish-republikat sovjetike nga Azia Qendrore janë anëtare, po ashtu. Vetëm Turkmenistani nuk është pjesë e tij. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, dhe lideri i Kinës, Xi Jinping, u takuan në ditën e parë të samitit në Astana.

Mediet ruse e cituan Putinin duke thënë se SCO-ja “po e forcon rolin si një prej shtyllave kryesore të një rendi botëror të drejtë dhe shumëpolar”.

Xi, i cili i ka dhënë Rusisë mbështetje diplomatike përballë kundërshtimeve nga Perëndimi gjatë pushtimit dyvjeçar të Ukrainës, e quajti Putinin “mik të vjetër” në Astana. Ai përmendi “shpresat për miqësi ndër breza” si përgjigje për “ndryshimin e vazhdueshëm të situatës ndërkombëtare”.

Për herë të parë në histori, Kanadaja emëron një grua në krye të ushtrisë

OTAVA, 4 KORRIK - Kanadaja ka emëruar një grua si ushtarakën më të lartë të vendit për herë të parë, duke vazhduar shtytjen e kryeministrit Justin Trudeau për t'i emëruar gratë në punët më të larta.

Gjeneralletënant Jennie Carignan, e ngarkuar me përpjekjet për ta eliminuar seksizmin e rrënjësor dhe

sjelljen e keqe në forcat e armatosura, do ta marrë detyrën më 18 korrik si shefe e shtabit të mbrojtjes.

Carignan, fillimisht një inxhinierë ushtarake, ka komanduar trupa në Afganistan, Bosnjë-Hercegovinë, Irak dhe Siri gjatë 35 viteve të saj në ushtri. “Gjatë karrierës së saj, cilësitë e saj të jashtëzakonshme

drejtuese, përkushtimi ndaj përsosmërisë dhe përkushtimi ndaj shërbimit kanë qenë një pasuri e jashtëzakonshme për Forcat tona të Armatosura”, ka thënë Trudeau në një deklaratë. Carignan merr postin në një kohë kur Kanadaja është në presion të aleatëve për t'i rritur shpenzimet e saj të mbrojtjes.



Hovenieri: Presim nga Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë pa parakushte dhe urgjentisht obligimet nga dialogu



PRISHTINË, 4 KORRIK - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se Shtetet e Bashkuara presin nga Kosova dhe nga Serbia t'i zbatojnë pa parakushte dhe me urgjencë të gjitha detyrimet që i kanë pranuar në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. "Ne presim nga Kosova dhe nga Serbia që t'i përmbushin të gjitha detyrimet që i kanë pranuar në dialog, përfshirë Marrëveshjen Bazë dhe Aneksin e Ohrit dhe ta bëjnë këtë me urgjencë, pa parakushte dhe pa i lidhur ato me çështje të jashtme", tha Hovenieri në një intervistë për "Rubikon" në "Klan Kosova" që u transmetua të mërkurën mbrëma. Kosova dhe Serbia e arritën Marrëveshjen për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve në fillim të vitit 2023, por ajo nuk ka gjetur zbatim nga asnjë palë deri tani.

Takimi i kësaj jave në mes të kryenegociatorit të Kosovës dhe atij të Serbisë në Bruksel për zbatimin e Marrëveshjes nuk solli rezultat. Kosova e akuzoi palën

serbe se dëshiron vetëm zbatimin e pjesëshëm të Marrëveshjes Bazë, ndërsa Serbia e kritikoi palën e Kosovës se nuk dëshiron ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, që është pjesë e pajtimit.

Javën e kaluar, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë qëndrimit në Bruksel për dialogun, i vuri tri kushte për ta takuar presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq: nënshkrimin e Marrëveshjes Bazë, tërheqjen e letrës me të cilën Serbia refuzoi zyrtarisht ta zbatonte marrëveshjen me Kosovën, dhe dorëzimin në Kosovë të Millan Radoičiqit, i dyshuar për organizimin e sulmit të armatosur në Banjskë.

Vuçiqi nuk i pranoi kushtet e tij dhe takimi dështoi. I pyetur për këtë, Hovenieri tha se Marrëveshja Bazë është "plotësisht zyrtare" pavarësisht se nuk është nënshkruar nga palët. BE-ja ka thënë, gjithashtu, se marrëveshja është ligjërish e detyrueshme. "Kjo është një marrëveshje

ligjërish e detyrueshme për të dyja vendet. Ky është qëndrimi ynë. Kështu e trajtojmë ne. Dhe ne presim nga të dyja vendet ta zbatojnë atë", theksoi Hovenieri. Ai shtoi se Shtetet e Bashkuara besojnë se njohja e ndërsjellë duhet të jetë rezultati përfundimtar i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që ka nisur më 2011. "Mendoj se ka disa njerëz në Kosovë që brengosen kur ne themi 'normalizimi i marrëdhënieve'. Kjo nuk është diçka që kërkohet përfundimisht. Sepse qëndrimi i Shteteve të Bashkuara ka qenë i qartë në mënyrë dypartiake. Shtetet e Bashkuara besojnë se rezultati përfundimtar i këtij procesi mund të jetë vetëm njohja e ndërsjellë", shtoi ai.

Hovenieri theksoi se draft-statuti evropian për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë nuk është "non-paper", duke hedhur poshtë pretendimin e kryeministrit Kurti. Vitin e kaluar Bashkimi Evropian,

si ndërmjetës i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, ua paraqiti palëve një draft-statut për Asociacionin, i cili u pranua në parim. Por, më vonë, kryeministri Kurti e cilësoi këtë dokument si "non-paper".

Në gjuhën e institucioneve evropiane, "non-paper" është një dokument joformal, i cili ekspozohet në negociata të mbyllura brenda institucioneve të BE-së, në përjekje për të gjetur marrëveshje për ndonjë çështje të kontestuar. "Të jemi të qartë, ky nuk është non-paper, ky nuk është diçka që ne thjesht ua dorëzuam atyre rastësisht. Ne e dorëzuan atë duke thënë se besojmë se [drafti] krijon një Asociacion që i mbron të gjitha shqetësimet që i keni paraqitur ju, i cili nuk kërkon asnjë ndryshim në Kushtetutën [e Kosovës], i cili nuk ka autoritet ekzekutiv. Kjo i mjafton Kosovës për ta përmbushur detyrimin e saj për themelimin e Asociacionit përmes këtij drafti", tha ai. Ai i bëri thirrje përsëri Kosovës ta dërgojë këtë draft në Gjykatë

Kushtetuese për vlerësim dhe ta shfrytëzojë mundësinë për të lëvizur përpara.

Por, Kurti tha kohë më parë se emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, mund ta dërgojë draftin për Asociacionin në Komisionin e Venedikut.

I pyetur për këtë, Hovenieri tha se Komisioni i Venedikut nuk e zgjedh problemin thelbësor në lidhje me Asociacionin. "Epo, a e dini se kush mundet? Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Do të ishte mirë që Qeveria e Kosovës ta ndërmarrë këtë hap", theksoi ai. Në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga BE-ja, Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin: më 2013 dhe 2015.

Më 2015 Gjykata Kushtetuese tha se Marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit nuk ishte në harmoni të plotë me aktin më të lartë juridik të shtetit. Harmonizimi, sipas Kushtetueses, mund të bëhet përmes akteve nënligjore.

Lajçaku diskuton për dialogun Kosovë - Serbi me sekretarin spanjoll për BE-në

Prishtinë, 4 korrik - I dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar me sekretarin e shtetit të Spanjës për BE-në,

Fernando Mariano Sampedro Marcos. Takimi i tyre ndodhi në margjinat e Forumit Ekonomik Botëror dhe në

aktivitetet e think-tankut pan-evropian, Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë në Madrid. Lajçaku ka njoftuar se me

spanjollin Marcos kanë diskutuar për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe çështjet e tjera në Ballkan. "Ne patëm një

diskutim të gjerë dhe të dobishëm rreth dialogut dhe çështjeve më të gjera të Ballkanit Perëndimor", ka shkruar Lajçak në "X".



Pesë gjëra që pritet të ndodhin në samitin e NATO-s në Uashington

PRISHTINË, 4 KORRIK - Samiti i madh i NATO-s në Uashington do të mbahet së shpejti, nga 9 deri më 11 korrik. "Radio Evropa e Lirë" shpjegon pesë gjërat të cilat duhet t'i ndiqni me vëmendje gjatë tubimit të 32 vendeve aleate dhe disa mysafirëve të rëndësishëm në kryeqytetin amerikan.

A është Ukraina vërtet afër anëtarësimit në aleancë?

Një prej gjërave kryesore që do të bjerë në sy gjatë këtij samiti është formulimi në deklaratën përfundimtare në lidhje me gjasat e Ukrainës për anëtarësim në NATO.

Përpilimi i këtij dokument, i cili përbëhet zakonisht nga disa faqe, është duke ndodhur tash e disa javë në zyrat qendrore të NATO-s në Bruksel. Por, mospajtimet kryesore kanë të bëjnë me mënyrën e saktë të përshkrimit të gjasave të Ukrainës për t'iu bashkuar aleancës.

Ukraina nuk do të ftohet për t'iu bashkuar NATO-s tash, kjo është shumë e qartë.

NATO-ja ka qenë e prerë se Ukraina nuk mund t'i bashkohet asaj derisa lufta është duke vazhduar, sepse vendet anëtare nuk duan të zhyten në një konfrontim të drejtpërdrejtë me Rusinë.

Mund të hidhen poshtë edhe idetë kreative por të pamundura për lejimin e klauzolës së përbashkët të NATO-s për mbrojtjen, Neni 5, ta mbulojë territorin ukrainas që është tash për tash nën kontrollin e Kievit, por jo edhe pjesën që Moskë e ka

pushtuar. Sipas zyrtarëve të NATO-s, ideja është që në samitin e sivjetmë të shkohet më larg krahasuar me deklaratën e Vilniusit nga samiti në kryeqytetin lituanëz vitin e kaluar.

Edhe këtë herë pritet diçka e ngjashme, apo madje gjuha e ngjashme, edhe pse gjasat janë që nuk do të caktohet ndonjë datë. Në komunikatën e Vilniusit u theksua se "ne do të jemi në gjendje t'ia dërgojmë ftesën Ukrainës për t'iu bashkuar aleancës kur aleatët të jenë pajtuar, dhe kur kushtet të jenë pjekur".

REL-i ka mësuar se dy aspekte mund të përfshihen në dokumentin e sivjetmë. Zyrtarët amerikanë, sikurse sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, së voni e kanë përdorur termin "ura drejt anëtarësimit" kur kanë folur për Ukrainën dhe NATO-n, prandaj pritet që kjo të zërë vend në komunikatën përfundimtare, edhe në qoftë se është e paqartë se çfarë nënkupton kjo fjali saktësisht.

Një fjalë tjetër që mund të përfshihet në komunikatë është fjala "e pakthyeshme", që nënkupton se rruga e Kievit drejt NATO-s është e shtruar.

Çfarë do të fitojë Ukraina?

Para së gjithash, shumë aleatë pritet të njoftojnë në samit më shumë furnizim dypalëshe me armë për Ukrainën. Pyetja, si gjithmonë, do të jetë se sa shpejt do të arrijnë armët në fushëbetejë. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, pritet të jetë i pranishëm

në samit dhe ka shpresë në mesin e zyrtarëve të NATO-s se nuk do të ketë një përsëritje të samitit të Vilniusit, në të cilin ai shprehu zhgënjimin në një postim në X para takimit, se Kievit nuk i ishte dhënë një orar i qartë për anëtarësim.

Në fakt, pak a shumë është arritur pajtueshmëri për dy temat e mëdha që do të bëhen të ditura në samit.

NATO-ja do të fillojë ta marrë përsipër bashkërendimin e dhurimit të armëve dhe municioneve Ukrainës. Deri tani, këtë e bënte grupi Ramstein i udhëhequr nga ShBA-ja, pjesë e të cilët janë mbi 50 vende kryesisht perëndimore, të cilat janë takuar rregullisht prej se Rusia e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës më 2022.

Njoftimi i dytë do të jetë financimi ushtarak i Ukrainës. Shifra të ndryshme janë përmendur. Shefi i NATO-s Stoltenberg së pari propozoi rreth 100 miliardë dollarë për pesë vjet. Tani, duket se aleatët kanë ardhur në përfundim për 40 miliardë dollarë për shumë vjet.

Skepticizmi i Trumpit

Nuk ka se si të shmangët kjo. Ish-presidenti amerikan (mbase presidenti i ardhshëm amerikan), Donald Trump, mund të jetë njeriu për të cilin flitet më së shumti në një samit pa qenë fare i pranishëm atje. Konventa Kombëtare Republikane, ku Trumpi do të caktohet zyrtarisht kandidat i partisë për president amerikan, do të nisë vetëm katër ditë pas samitit.

Në një mënyrë apo tjetër, samiti i NATO-s do të bëhet pjesë e fushatës zgjedhore. Shumë prej

mesazheve dhe vendimeve që do të dalin nga samiti, do të jenë përgjigje për skepticizmin e Trumpit për aleancën dhe për mbështetjen e vogël që ai ka treguar për përpjekjet e Ukrainës për luftë.

Një tjetër gjë që e ka brengosur Trumpin ka të bëjë me shpenzimet ushtarake të aleatëve evropianë. Në të kaluarën, Trump i ka kritikuar vendet anëtare që nuk e kanë arritur cakun e NATO-s prej 2 për qind të GDP-së për shpenzim në mbrojtje, si dhe ka thënë se do ta lejonte Rusinë t'i sulmojë ato vende të cilat nuk paguajnë, duke e vënë në dyshim parimin thelbësor të NATO-s.

Për këtë, në samitin e Uashingtonit do të flitet për shumë shifra në lidhje me atë se sa shumë i kanë rritur aleatët shpenzimet në vitet e fundit. Më 2014 u dha një zotim se të gjitha vendet anëtare duhet ta arrijnë cakun prej 2 për qind brenda një dekade. Ky zotim nuk është përmbushur plotësisht, sepse 23 nga 31 vende aëntare sot shpenzojnë kaq ose më shumë për ushtrinë.

Por, NATO-ja do të përgjigjet shpejt për të nënvizuar se ky numër është i "vjetër" dhe se Evropa dhe Kanadaja kanë shpenzuar 640 miliardë shtesë në mbrojtje prej atëherë.

Një rikujtim nga Vilnius

Përveç Këshillit NATO-Ukrainë në nivel liderësh, do të ketë edhe dy sesione të tjera pune në samit. I pari ka të bëjë me atë se sa e përgatitur është NATO-ja në rast se do të sulmohej. Vitin e kaluar në Vilnius, u miratuan një numër

planesh për mbrojtjen, në mënyrë që të mbrohej "çdo centimetër e territorit të NATO-s".

Tani duhet të shikohet nëse ato plane janë duke kryer punë - më e rëndësishmja për të parë nëse armët dhe logjistika janë të vendosura. NATO-ja i ka 500.000 trupa në gjendje gatishmërie dhe është duke stërvitur në një shkallë të paparë prej Luftës së Ftohtë. Por, një zyrtar i NATO-s e pranoi se planet "janë funksionale", por shtoi me kujdes: "Nëse NATO-ja sulmohet sot, ato do të funksionojnë, por ka ende gjëra që mungojnë".

Është thënë se kundërajrorët në krahun lindor të aleancës kanë mungesë municioni, por blloku ka nevojë për më shumë raketa me rreze të gjata veprimi dhe tanke.

Sesioni i dytë i kushtohet Kinës. Derisa aleanca është ende e përqendruar në teatrin atlantik, është e qartë se po i vëzhgon me një sy edhe zhvillimet në Paqësor dhe ndikimin e Kinës atje, e shtyrë kryesisht nga Shtetet e Bashkuara. Sikurse në dy samitet e fundit, liderët e NATO-s nga Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Koreja e Jugut, do të jenë të pranishëm. Pritet nënshkrimi i shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushat si, mbrojtja kibernetike dhe siguria detare.

Çfarë do të ndodhë në të ardhmen?

Natyrisht, presidenti amerikan, Joe Biden, do ta tërheqë vëmendjen e të gjithëve, i cili është nikoqir i takimit, posaçërisht pas paraqitjes së tij të dobët në

ShBA-ja feston 248-vjetorin e pavarësisë, Kosova e uron dhe kujton aleancën e fuqishme me të

Me rastin e kësaj dite, togu ceremonial i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka ngritur të enjten flamurin amerikan në Prishtinë te shtatorja e ish-presidentit amerikan Bill Clinton, ndërkaq liderët shtetërorë të Kosovës dhe ata të opozitës e kanë uruar ShBA-në, duke theksuar se si popull dhe si shtet mbesin përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 KORRIK - Shtetet e Bashkuara të Amerikës të enjten kanë shënuar 4 korrikun - Ditën e Pavarësisë. Me rastin e kësaj dite, togu ceremonial i FSK-së ka ngritur flamurin amerikan, ndërkaq liderët shtetërorë dhe ata të opozitës e kanë uruar ShBA-në, duke theksuar se si popull dhe si shtet mbesin përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se më 4 korrik kujtojmë vlerat e ideat mbi të cilat janë ndërtuar Shtetet e Bashkuara dhe aleanca jonë e fuqishme. "Aleancë që vazhdon t'i mbijetojë kohës dhe sfidave! Sot populli i Kosovës feston krahas popullit amerikan. Sot kujtojmë vlerat e ideat mbi të cilat janë ndërtuar Shtetet e Bashkuara dhe aleanca jonë e fuqishme! Aleatëve tanë amerikanë: Gëzuar 4 Korriku!", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se Dita e Pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

është festë e popullit dhe shtetit amerikan, por dhe burim frymëzimi për këdo anëtarë botës, shembull i idealit të lirisë, barazisë dhe e vullnetit të popullit në të drejtën e vet. "Është ditë kur kremtohet demokracia dhe fitorja e saj, kur kujtohen me respekt përpjekjet e atyre që me vendosmëri e sakrificë e mbajtën gjallë, deri në realizimin e tij, atë vizion çlirues që do të sillte përparimin më të jashtëzakonshëm brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe efekte të mëdha në mbarë botën. Në këtë frymë, por në një kontekst tjetër, ShBA-ja vazhdon t'i prijë përpjekjes së aleancës së demokracive për ta ruajtur idealin e lirisë dhe barazisë së popujve, në luftën e pakompromis kundër autoritarizmit dhe pushtimit", ka shkruar Konjufca në "Facebook". Ai ka shtuar se si popull dhe si shtet jemi të lumtur që i përkasim kësaj aleance demokratike, përkrah ShBA-së për t'i mbrojtur idealin dhe për t'i realizuar qëllimet tona të përbashkëta. "Popullit amerikan dhe Shteteve të Bashkuara dua t'ua



uroj nga zemra 4 Korrikun, këtë ditë të madhe të lirisë!", ka theksuar Konjufca.

Edhe kryeministri Albin Kurti ka uruar popullin amerikan për 4 Korrikun. "Më 24 qershor 1826, Thomas Jefferson shprehu një dëshirë të fundit: që Deklarata e Pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do ta frymëzonte edhe pjesën tjetër të botës që t'i thejë prangat' dhe t'ë pranojë bekimet dhe sigurinë e vetëqeverisjes'. Jefferson vdiq vetëm 10 ditë më vonë, më 4 korrik, në ditëlindjen e 50-të të vetë shtetit të cilin kishte ndihmuar ta themelonte. Gati 200 vjet pas vdekjes së Jefferson-it, ende punojmë palodhshëm për t'ia plotësuar dëshirën e fundit. Deklarata e Pavarësisë e Republikës së Kosovës, e shekullit XXI, përveçse ngjarje politike nga aspirata historike e popullit tonë, është frymëzuar prej të njëjtave ideale në të cilat u bazuan Jefferson dhe bashkëthemeluesit e tij në shekullin XVIII. Prej vendotimeve

në mbarë botën, deri te fushëbetet patriotike të Ukrainës plot guxim, le të vazhdojmë, gjithsecili, të bëjmë pjesën tonë në këtë përpjekje të përbashkët dhe të pafund: për ta mbajtur gjallë 'Frymën e '76-s', si për veten, ashtu edhe për brezat e ardhshëm", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Për 248-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së ShBA-së kanë shkruar edhe liderët e opozitës. Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se përkushtimi dhe mbështetja e palëkundur e treguar nga ShBA-ja ka frymëzuar shtetet anëtarë globit, përfshirë Kosovën, që të nisin një rrugë të re - atë të lirisë dhe të zhvillimit.

Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se sot Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë sinonim i kombit të madh, që angazhohet përherë për një botë më paqësore dhe më të sigurt.

Ditën e Pavarësisë ShBA-së ia ka uruar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

debatin përballë Trumpit. Kritikta do të jetë të mëdha, por pyetja është sa herë do të paraqitet ai në media gjatë asaj jave. Herët a vonë, ai duhet të takohet me shtypin, por ia vlen të theksohet se ai nuk mbajti konferencë në samitin e Vilniusit vitin e kaluar, që është gjë e pazakontë për një president amerikan.

Në Uashington ai duhet të jetë më i gjallë. Duke qenë mbrapa në sondazhet presidenciale, është e qartë se këshilltarët e tij do të duan që samiti të planifikohet dhe kontrollohet në mënyrë që ai ta shmangë çfarëdo gafe të panevojshme.

Por, Biden nuk është lideri i vetëm nga vendet e mëdha

perëndimore që po lufton për mbijetesë politike. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, do të mbërrijë në Uashington pas zgjedhjeve parlamentare, në të cilat aleanca e tij e qendrës së djathtë ka rënë nga grupi më i madh në fuqinë e tretë në Parlament, me vetëm 100 deputetë.

Në Gjermani, Olaf Scholz dhe koalicioni i tij pritet të pësojnë disfatë në zgjedhjet nacionale vitin e ardhshëm, që nënkupton se Berlino, Parisi dhe Uashingtoni përfaqësohen në shumë mënyra nga liderë të dobësuar politikisht.

Ndërkohë, shefi i ri i NATO-s, Mark Rutte, i cili e merr detyrën

zyrtarisht nga Stoltenberg në vjeshtë, do të ketë shumë punë. Stoltenberg, sekretari që shërbeu më së gjati në krye të NATO-s, do të mungojë posaçërisht për aftësitë e tij për të kaluar mirë me shumicën e liderëve dhe për gjetjen e pajtueshmërisë. Në këtë kuptim, Rutte do të jetë disi pasuesi i tij natyral.

Zyrapi thotë se Thaçi nuk ka pasur rol në mbikëqyrjen e punës së Gjykatës Ushtarake

PRISHTINË, 4 KORRIK - Dëshmitari Bislim Zyrapi para trupit gjykuës në Hagë mohoi që Hashim Thaçi të ketë pasur rol në mbikëqyrjen e punës së Gjykatës Ushtarake. "Sa më kujtohet mua, jo. S'ka pasur mundësi në atë kohë", tha ai. Më pas Zyrapi u pyet nëse ka pasur juristë të tjerë që mund të emëroheshin në Gjykatën Ushtarake përveç Sokol Dobrunës. "Nuk e di. E di që edhe një, sa më kujtohet ka qenë Agroni. Më duket Berisha. Kanë qenë edhe të tjerë, po nuk i di.

Nuk jam marrë me atë çështje që të di se kush ka qenë e sa kanë qenë", shtoi Zyrapi. Sipas avokatit Luka Mishetiç, dëshmitari i kishte thënë ZPS-së se të gjitha çështjet që kishin të bënin me disiplinën dhe respektimin e urdhrave në dhjetor të '98-s i kishin kaluar Sokol Dobrunës si shef i Drejtorisë Ligjore. "Po, e saktë është", tha dëshmitari dhe theksoi se ai kishte edhe detyrën e ekzaminimit të veprave të rënda penale, ndërsa masat disiplinore

iu përkisnin komandantëve të zonave. Dëshmitari deklaroi se për vepra të rënda penale e kishte fjalën për arrestimin e civilëve, maltretimin e tyre dhe nëse ndonjë ushtar ose komandant e kishte shkelur rregullin duke përdorur armën, në veçanti në pikat e kontrollit ose kishte shkelur urdhëresat e eprorit të tyre. Gjithashtu, për arrestimin e civilëve ai pohoi se nuk ishte çështje që merrej komandanti i zonave, por Sokol Dobruna.



Klinika e Onkologjisë bëhet me sistemin laserik C-RAD të gjurmimit optik 3D

PRISHTINË, 4 KORRIK - Në Klinikën e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është bërë promovimi i sistemit laserik C-RAD të gjurmimit optik 3D, duke e bërë kështu këtë institucion të vetmin në rajon me këtë teknologji të avancuar. Përdorimi i sistemit laserik C-RAD për pozicionim në radioterapi ofron një gamë të gjerë trajtimesh për pacientët, duke përfshirë terapi të precizionit dhe efikasitetit të lartë në trajtimin e sëmundjeve onkologjike. Kjo teknologji e fundit ofron një standard më të lartë kujdesi dhe



trajtimi për të gjithë pacientët që i nënshtrohen radioterapisë në Klinikën e Onkologjisë. C-RAD ofron një pozicionim shumë të saktë të pacientit, duke siguruar që rrezatimi të drejtohet saktësisht në zonën që duhet trajtuar, ndërsa minimizohet ekspozimi i indeve të shëndosha dhe komplikacionet edhe efektet anësore të mundshme pas trajtimit me radioterapi. Ndërkohë që shkurtojnë kohën e nevojshme për përgatitjen dhe trajtimin e pacientëve, duke përmirësuar efikasitetin e punës në klinikë.

Po kjo teknologji ofron zgjidhje për menaxhimin e lëvizjes së frymëmarrjes, duke lejuar trajtimin e saktë të tumoreve në zonat që lëvizin me frymëmarrjen, siç janë mushkëritë dhe gjoksi. Këto përfitime e bëjnë sistemin C-RAD një zgjidhje të duhur për pozicionimin e pacientëve në radioterapi, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të trajtimit. Pritet që brenda dy muajve, pas trajnimit të stafit mjekësor, të fillojë trajtimi i pacientëve me këtë teknologji të avancuar.

EULEX-i dhe Ministria e Drejtësisë konsolidojnë bashkëpunimin e vazhdueshëm në punën për personat e zhdukur

PRISHTINË, 4 KORRIK - Shefi i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kanë nënshkruar dy marrëveshje teknike që synojnë konsolidimin e vijimësisë së bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet EULEX-it dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) për rritjen e efektivitetit të punës për personat e zhdukur. "Marrëveshja teknike ndërmjet EULEX-it dhe IML-së për kryerjen e përbashkët të shqyrtimit të rasteve" përfshin ofrimin thelbësor të ndihmës nga Ekipi i Mjekësisë Ligjore i EULEX-it për IML-në në të gjitha aspektet teknike të kërkimit, zhvarrosjes dhe identifikimit të personave të

zhdukur në lidhje me konfliktin në Kosovë. "Marrëveshja teknike për instalimin e zyrave në kontejnerë në IML për një afat të mesëm: ka të bëjë me instalimin e përkohshëm të zyrave në kontejnerë nga EULEX-i në IML, si dhe synon të sigurojë vazhdimësi për marrëdhëniet e ngushta të punës ndërmjet Ekipit të Mjekësisë Ligjore të EULEX-it dhe personelit të IML-së deri në përfundimin e punimeve për riparimin e objektit IML-së, pasi objekti është dëmtuar nga zjarri. Zyrat në kontejnerë pritet të vendosen gjatë muajve të ardhshëm. Marrëveshjet teknike të nënshkruara sot ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të IML-së për kryerjen e punës për personat e zhdukur, siç parashihet nga "Strategjia për Drejtësinë Transicionale 2024-2034" e miratuar së fundmi.



Që nga fillimi i mandatit të tij deri më sot, EULEX-i ka punuar pa pushim për gjetjen dhe kthimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur te familjet e tyre, në mënyrë që ata të varrosen me respekt dhe dinjitet. Ekspertët e EULEX-it ofrojnë ekspertizë dhe këshilla për identifikimin e varreve klandestine

apo të pashënuara, si dhe zhvarrosjen dhe identifikimin e viktimave nga lufta e Kosovës dhe periudhën menjëherë pas saj. Misioni e mbështet IML-në për analizimin e mbetjeve mortore të pidentifikuara në morgun e Prishtinës. Në veçanti, që nga viti 2009, ekspertët

e EULEX-it kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në 806 operacione në terren për gjetjen e personave të zhdukur, duke përfshirë 210 zhvarrime. Mbetjet mortore të 507 personave janë identifikuar, duke përfshirë 348 persona të zhdukur. EULEX-i vazhdon të jetë i përkushtuar për t'i mbështetur homologët e tij në IML dhe institucionet e tjera përkatëse të Kosovës për ta zbuluar fatin e personave të zhdukur pavarësisht nga rrethanat e zhdukjes së tyre, përkatësisë së tyre etnike, fetare apo kombëtare, apo ndonjë karakteristikë tjetër. Puna e Misionit është që t'i ndihmojë institucionet e Kosovës që t'u japin përgjigje shumë të nevojshme familjeve dhe të dashurve të personave të zhdukur për ta realizuar të drejtën e tyre për ta ditur të vërtetën.

UP-ja hap konkursin për pranimin e studentëve të rinj

PRISHTINË, 4 KORRIK - Universiteti i Prishtinës ka hapur konkurs për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore baçelor për vitin akademik 2024/25. Gjithsej 5 285 studentë të rregullt do të kenë mundësinë të bëhen pjesë e UP-së për këtë vit akademik. "Të dashur maturantë, me kënaqësi ju njoftojmë se Universiteti i

Prishtinës ka shpallur konkursin për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore baçelor për vitin akademik 2024/2025. Gjithsej 5 285 studentë të rregullt do ta kenë mundësinë të bëhen pjesë e UP-së për këtë vit akademik në afatin e parë të konkursit. Universiteti ynë ofron një mjedis akademik të pasur dhe

mundësi të shumta për zhvillim profesional dhe personal. Për të gjithë të interesuarit, UP-ja ofron qindra programe studimore në 14 fakultete. Ju ftojme të bëheni pjesë e një institucioni me traditë dhe cilësi të lartë arsimore. Aplikimet janë të hapura deri më 16 korrik 2024", ka njoftuar UP-ja.



Dy projektligje nga Komisioni për Integrim Evropian i shkojnë Kuvendit

PRISHTINË, 4 KORRIK - Komisioni për Integrim Evropian, kryesuar nga Rrezarta Krasniqi, kryetare e këtij

komisioni, mbajti të enjten mbledhjen e radhës, në të cilën u shqyrtuan dhe u përkrahën dy projektligje.

Projektligjet e miratuara me këtë rast janë shqyrtuar nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Ato janë: Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të

Huaj në Republikën e Kosovës si dhe Projektligji për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Hamza në Prizren: PDK-ja, e gatshme për zgjedhje të reja

Prizren, 4 korrik - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Bedri Hamza, ka qëndruar për vizitë në komunën e Prizrenit. Ai ka thënë se PDK-ja është e gatshme për zgjedhje të reja. "Në kuadër të vizitave mobilizuese në terren, sot bashkë me Uranin i vizituam Shaqën e Kujtimin në Prizren dhe dolëm pak në Shatërvanin e bukur. PDK-ja, e cila ka dalë e para në zgjedhjet lokale, ka qenë dhe është çdoherë e gatshme për

zgjedhje të reja. Vendit do t'ia ofrojmë një qeveri kompetente, të përgjegjshme para qytetarëve dhe aleatëve tanë, me një program konkret, të realizueshëm dhe me indikatorë të matshëm, të cilin do ta prezantojmë gjatë muajve të ardhshëm. Së bashku me çdo njeri vullnetmirë, me çdo qytetar që është lodhur nga kjo gjendje e pashpresë dhe dëshiron një jetë më të mirë këtu, në vendin tonë, ne do ta bëjmë ndryshimin", ka thënë Hamza.



LV-ja dhe PDK-ja bllokuan pjesëmarrjen e qytetarëve në planin zhvillimor të Prishtinës



PRISHTINË, 4 KORRIK - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të enjten u bënë bashkë për ta bllokuar vënien në diskutim publik të Planit Zhvillimor të Prishtinës, i cili është dokumenti më i rëndësishëm për zhvillimin e kryeqytetit për periudhën 2024-2032.

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, tha se LV-ja dhe PDK-ja kanë bllokuar pjesëmarrjen e qytetarëve në planin zhvillimor të Prishtinës. "LV-ja dhe PDK-ja u bënë bashkë për të bllokuar vënien në diskutim publik të Planit Zhvillimor të Prishtinës, i

cili është dokumenti më i rëndësishëm për zhvillimin e kryeqytetit për periudhën 2024-2032. Ky bojkot nga LV-ja dhe PDK-ja, është në dëm të qytetarëve të Prishtinës sepse ua pamundëson të drejtën e tyre ligjore dhe kushtetuese për kontribut në këtë dokument të rëndësishëm. Me këtë rast, i falënderoj përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Aleancës Kosova e Re, Nisma dhe Lëvizja për Bashkim për përkrahjen e vazhdueshme në zhvillim të kryeqytetit", ka shkruar Rama në "Facebook".

Albert Zogaj rizgjedhet kryesues i KGJK-së edhe për një mandat

Prishtinë, 4 korrik - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në takimin e 328, ka miratuar rizgjedhjen e kryesuesit të KGJK-së, Albert Zogaj, pas procesit të votimit unanim të anëtarëve.

Mandati i ri i kryesuesit Zogaj fillon më 7 korrik 2024 deri në përfundimin e mandatit të tij si anëtar i KGJK-së.

Kryesuesi Zogaj paraqiti

vizionin dhe objektivat e tij duke u zotuar se gjatë mandatit të ri do ta vazhdojë përkushtimin për ngritjen e transparencës, llogaridhënies dhe nivelit të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Anëtarët e KGJK-së kanë vlerësuar punën dhe përkushtimin e kryesuesit Zogaj në përmirësimin e sistemit gjyqësor në Kosovë gjatë

mandatit të tij deri më sot, ku nën drejtimin e tij, KGJK-ja dhe gjykatat kanë arritur përparim në forcimin e transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor.

Po ashtu, kryesuesi i falënderoi anëtarët e Këshillit për besimin dhe shprehur përkushtimin për të punuar për avancim të drejtësisë dhe rritje të besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.



Në UP përfundojnë me sukses trajnimet e QPM-së për semestrin veror



PRISHTINË, 4 KORRIK - Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) ka përfunduar me sukses ciklin e fundit të moduleve trajnuese për semestrin veror.

Vetëm gjatë muajit qershor

mbi 150 pjesëmarrës/staf akademik kanë ndjekur një mori të larmishme të moduleve trajnuese, që synojnë prezantimin e praktikave më të mira dhe të reja të mësimdhënies.

UP-ja është e përkushtuar

për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ajo përfshin investime në zhvillimin e kurrikulave inovative dhe në trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik.

QPM-ja vazhdon sesionet trajnuese në shtator.

Kapen 150 kilogramë djathë të padeklaruar në linjën e autobusit Tiranë - Prishtinë

PRISHTINË, 4 KORRIK - Në pikën kufitare të Vërmicës njësitet antikontabandë të Doganës së Kosovës kanë selektuar për kontroll një autobus që qarkullonte në linjën Tiranë - Prishtinë. Gjatë kontrollit vozitësi është pyetur nëse kishte ndonjë gjë për të deklaruar. Pasi ka deklaruar se

nuk kishte asgjë, është filluar kontrolli i hollësishëm. Gjatë kontrollit është gjetur e fshehur dhe e padeklaruar një sasi e konsiderueshme e djathërave të ndryshme me origjinë nga Italia. Malli i padeklaruar është ndaluar, në total rreth 150 kg. Përveç tentimit të shmangies

së taksave, këto produkte nuk kanë plotësuar kushtet higjienike të transportit dhe mund ta rrezikonin shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Dogana e Kosovës ka theksuar se vazhdon të jetë e përkushtuar për parandalimin e kontrabandës dhe mbrojtjen e ekonomisë së vendit.



Lansohet projekti i digjitalizimit në AVU, vlera e tij 1,95 milion euro

PRISHTINË, 4 KORRIK - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë në lansimin e projektit të digjitalizimit në Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit, projekt i cili është mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian. Me këtë rast, ministri Peci ka theksuar se lansimi i këtij projekti shënon një avancim të çmuar kur bëhet fjalë për modernizim e shumë aspekteve të cilat kanë të bëjnë me trajtimin e dokumentacionit, mbi të gjitha vlerësoi se digjitalizimi i avancuar rritë sigurinë ushqimore dhe e bën më shumë transparente punën e AUJ-së.

Ndër të tjera, ministri Peci tha se ky sistem do ta lehtësojë punën edhe në fushën e subvencioneve dhe granteve që Qeveria e Kosovës jep për fermerët, prodhuesit dhe përpunuesit. "Në të kaluarën ndaj kësaj kategorie të rëndësishme të ekonomisë sonë ishin krijuar panevojshëm barrierat gati të patejkalueshme burokratike. Pikërisht për këtë, ndër objektivat



tona si MBPZHR është eliminimi i burokracive dhe lehtësimi i punës me dokumentacionin. Operatorët e biznesit në kuadër të sektorit të ushqimit tani kanë mundësinë e lehtë të kenë qasje në dosjet

digjitale. Çdo inspektim është i gjurmueshëm dhe mbetet pjesë e dosjes digjitale. Gjithashtu, mundësohet menaxhim adekuat me matriculat", tha ministri Peci. Ky projekt ai ka vlerësuar se

paraqet hapin më të rëndësishëm në reformën që kanë ndërmarrë si dhe përafrojnë edhe më tej politikën dhe legjislacionin kombëtar me kërkesat e acquis të BE-së. "Falë miqve tanë nga Zyra e BE-së, tani

sistemet digjitale në dispozicion të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës trajtojnë dhe procedojnë vëllime të mëdha të dhënash për t'i identifikuar tendencat dhe modelet në prodhimin, importin, eksportin, shpërndarjen dhe trajtimin e ushqimit", tha ministri Peci.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i AUJ-së, Bekim Hoxha, tha se ky mekanizëm do ta vendosë AUJ-në në nivelin e autoriteteve evropiane për llogaridhënie, transparencë dhe shërbime kontrolli lehtë të qasshme dhe të mbikëqyrrura.

Përfaqësuesi nga Zyra e BE-së në Kosovë, Olivier Boudart, theksoi se Sistemi i Kontrollit dhe Gjurmueshmërisë së Ushqimit, i zhvilluar me ndihmën financiare të BE-së, është një moment i ri historik në punën e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës.

Projekti i digjitalizimit në AUJ, i mbështetur nga Zyra e BE-së, arrin vlerën prej 1,95 milion eurosh.

Guvernatori i BQK-së merr pjesë në tryezën e nivelit të lartë në projektin "We Lead" të financuar nga BE-ja



PRISHTINË, 4 KORRIK - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili mori pjesë si folës në tryezën e nivelit të lartë të projektit rajonal "We Lead", i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe organizuar nga Qendra e Ekselencës në Financa (CEF) në Lubjanë të Sllovenisë. Kjo ngjarje mbledhi së bashku drejtues të institucioneve dhe guvernatorë nga rajoni për të diskutuar mbi kompleksitetin dhe sfidat me të cilat përballen institucionet e tyre, duke u fokusuar në zgjidhjet dhe praktikën më të mirë. Guvernatori Ismaili në këtë panel mori pjesë së bashku me zëvendëskryeministrat, njëherësh ministrin e Financave të Sllovenisë dhe atë të Kroacisë, guvernatorin e Malit të Zi, zëvendëskryeministrin e

Financave të Bosnjë-Hercegovinës dhe një përfaqësues të Komisionit Evropian.

Gjatë kësaj tryeze guvernatori Ismaili theksoi iniciativat strategjike të BQK-së për avancimin e proceseve të brendshme dhe forcimin e kapaciteteve të institucionit.

Në fjalën e tij, guvernatori Ismaili nënvizoi qasjen proaktive të BQK-së për zhvillimin e burimeve njerëzore, duke theksuar rëndësinë e veprimeve konkrete dhe investimeve në ndërtimin e aftësive specifike për bankat qendrore.

Ai nënvizoi përkushtimin e BQK-së për ta nxitur rritjen dhe zhvillimin profesional përmes iniciativave dhe programeve të ndryshme të dizajnuara për ta pajisur personelin me ekspertizën e nevojshme.

"Termokos"-i vazhdon përgatitjet për sezonin e ardhshëm, nis zgjerimi i rrjetit në pjesë të tjera të qytetit

PRISHTINË, 4 KORRIK - Ngrohitorja e qytetit "Termokos" ka vazhduar përgatitjet për sezonin e ardhshëm, duke zgjeruar rrjetin në pjesë tjera të kryeqytetit.

Të enjten ekipet e "Termokosit" kanë punuar për zgjerimin e rrjetit dhe punimet në ndërtimin e objektivit. "Vazhduam me implementimin e planit aksional,

përmes të cilit synojmë ngritjen e cilësisë së shërbimit dhe në ditët e tjera do të vazhdojmë me zgjerimin e rrjetit", thuhet në njoftimin për medie.



Zbulimi i artit më të vjetër në botë

Nga shkencëtarë australianë dhe indonezianë, në ishullin Sulaezi të Indonezisë është zbuluar shembulli më i vjetër i artit figurativ në shpella.

Piktura e një derri të egër dhe e tre figurave të ngjashme me njeriun, është të paktën 51 mijë 200 vjet e vjetër, mbi pesë mijë vjet më e vjetër se arti i mëparshëm më i vjetër shpellor.

Zbulimi e shtyn prapa kohën kur njerëzit modernë për herë të parë shfaqën aftësinë për mendim krijues.

Profesori Maxime Aubert nga Universiteti Grifit në Australi, tha se zbulimi do të ndryshojë idetë rreth evolucionit njerëzor.

“Piktura tregon një histori komplekse. Është dëshmia më e vjetër që kemi për të rrëfyerit. Tregon se njerëzit në atë kohë kishin aftësinë për të menduar me terma abstraktë”, tha ai.

Piktura shfaq një derr që qëndron në këmbë, me gojën pjesërisht të hapur dhe të paktën tre figura të ngjashme me njeriun.

thelbësore e kulturës së hershme njerëzore në Indonezi.

“Njerëzit ndoshta kanë treguar histori për më shumë se 51 mijë e 200 vjet, por meqë fjalët nuk fosilizohen, mund të vazhdojmë vetëm me anë të përafrimeve indirekte, si përshkrimet e skenave në art – dhe arti Sulaezi tani është dëshmia më e vjetër e tillë që njihet në arkeologji”, tha ai.

Provat e para të vizatimit u gjetën në shkëmbinj në shpellat Blombos në Afrikën jugore dhe datojnë 75-100 mijë vjet më parë. Përbëhen nga modelet gjeometrike.

Piktura e re, në shpellën gëlqerore të Leang Karampuangut në rajonin Maros-Pangkep të Sulaezitet Jugut, shfaq artin përfaqësues – përfaqësimin abstrakt të botës rreth personit ose njerëzve që atë e kanë pikturuar.

Prandaj, përfaqëson evolucionin në proceset e mendimit në specien tonë që ia dhanë fillin artit dhe shkencës.

Dr. Henry Gee, redaktor në revistën Nature ku u botuan detajet, pyet se



Kjo pikturë është shembulli më i hershëm i njohur i artit përfaqësues

çfarë e nxiti këtë zgjim të mendjes njerëzore.

“Duket se diçka se ka ndodhur rreth 50 mijë vjet më parë, menjëherë pasi vdiqën të gjitha speciet e tjera njerëzore – si Neandertalët dhe të ashtuquajturit Hobitët. Është romantike të mendosh se në një moment, në atë kohë, diçka ka ndodhur në trurin e njeriut, por mendoj se ka më shumë gjasa që të ketë shembuj edhe më të hershëm të artit përfaqësues”.

Profesori Chris Stringer i Muzeut të Historisë Natyrore në Londër,


beson se mund të ketë shembuj të artit të lashtë përfaqësues në Afrikë, ku njerëzit modernë fillimisht evoluuan, por ende nuk është gjetur asgjë e tillë.

“Kjo gjetje përforcon idenë se arti përfaqësues u prodhua për herë të parë në Afrikë, para 50 mijë vjetëve dhe se koncepti u përhap me përhapjen e specieve tona. Nëse kjo është e vërtetë, ende nuk janë shfaqur provat e reja mbështetëse nga zonat e tjera, përfshirë Afrikën. Natyrisht, kjo datë më e vjetër është njëra pamje e tablosë – shpresojmë se do të ketë data të


reja në më shumë lokacione për të konfirmuar këtë gjetje kuciale”.

Kjo u bë e mundur duke përdorur një metodë të re që përfshin prerjen e sasive të vogla të artit përmes laserit. Kjo ua mundëson studiuesve të studiojnë pjesë të ndryshme dhe detaje të veprës së artit, e pastaj të dalin me datë më të saktë.

Teksa metoda e re po përdoret më gjerësisht, në disa vende me art shpellor, në të gjithë botën, mund të caktohen datat e tjera, ndoshta duke e shtyrë më tej shfaqjen e artit përfaqësues.



Pikturat u gjetën në shpellat e Kodrës Karampuang, në ishullin indonezian të Sulaezitet Jugut



Kjo pikturë është shembulli më i hershëm i njohur i artit përfaqësues



Këto modele gjeometrike të bëra më shumë se 75 mijë vjet më parë në Afrikën Jugore, janë dëshmia e parë e vizatimit, por nuk paraqesin artin përfaqësues

Figura më e madhe e njeriut i ka të dy krahët e zgjatur dhe duket se mban një thupër. E dyta është menjëherë përballë derrit me kokën pranë feçkës. Gjithashtu duket se mban një shkop, njëri skaj i të cilit mund të jetë në kontakt me fytyrën e derrit. Figura e fundit e ngjashme me njeriun duket se është me kokën poshtë, me këmbët e drejtuara lart. Ka një dorë që shtrihet drejt dhe që duket se prek kokën e derrit.

Ekipi i shkencëtarëve u drejtua nga Adhi Agus Oktaviana, specialist indonezian i artit shkëmbor nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit dhe Inovacionit (BRIN) në Xhakartë. Ai thotë se tregimi narrativ ishte pjesë



Këto piktura në shpellën Sumpang Bita në Sulaezin e Jugut, dikur mendohej se kishin 39 mijë vjet dhe se ishin ndër më të vjetrat në botë



Pikturat si kjo në Francën jugperëndimore, shtyn disa të besonin gabimisht se mendimi abstrakt për herë të parë u shfaq në Evropën Perëndimore

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT
EURO2024 GERMANY



Xhaka: Loja ndaj Anglisë, e veçantë për mua

CYRIH, 4 KORRIK - Zvicra do të përballet me Anglinë të shtunën në çerekfinale të Kampionatit Evropian. Para kësaj ndeshjeje, kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, ka dhënë një intervistë për mediumin zviceran "20min.ch". "Anglia ka shumë më shumë lojtarë se kombet e tjera që luajnë në

ligën e tyre vendase. Kjo bën që për mua të jetë e veçantë, pasi gjatë kohës sime në Premierë Ligë kam luajtur kundër shumë prej tyre disa herë. Megjithatë, në thelb është një ndeshje eliminatorie si çdo tjetër. Ne kemi vetëbesim dhe jemi të fokusuar në forcat tona, pavarësisht prej

kundërshtarit", ka thënë Xhaka. Nëpër disa medie të mëdha po përflitet emri i Xhakës si kandidat për "Topin e Artë", teksa Xhaka ka thënë se ai do ta japë maksimumin dhe është i fokusuar vetëm në "Euro 2024". "Unë gjithmonë kam theksuar që aftësitë e mia duhet të vlerësohen nga të

tjerët. Kur flitet papritur për Balon D'Or, është natyrisht falënderuese. Por ju gazetarët gjithashtu duhet gjithmonë të shkruani diçka të re (qesh). Unë mendoj vetëm për këtu dhe tani, që është çerekfinalja e 'Euro 2024' kundër Anglisë. Unë do të jap gjithçka në fushë si gjithmonë dhe do të



përpiqem ta ndihmoj sa më mirë ekipin, sepse vetëm si ekip mund të bëjmë diçka historike", u shpreh Xhaka.

'Euro 2024', sonte superndeshjet Spanjë - Gjermani dhe Portugali - Francë

"Epoka e re"

STUTTGART, 4 KORRIK - Sonte zhvillohen dy ndeshjet e para çerekfinale në Kampionatin Evropian "Euro 2024" i cili po mbahet në Gjermani. Nga ora 18:00 në "MHPArena" të Stuttgartit një prej kombëtareve kryesore për ta fituar trofeun, Spanja, do të përballet me Gjermaninë vendase që, po ashtu, ka treguar potencial të madh në këtë eveniment.

Futbollisti i Spanjës, Mikel Oyarzabal, ka thënë se i respektojnë gjermanët, por nuk kanë aspak frikë. "Gjermania është një ekip i madh dhe me nivel individual të lartë. Ka lojtarë që bëjnë diferencën, të cilët kanë pasur një sezon të shkëlqyer, por ne kemi shumë besim. I respektojme, por nuk ua kemi frikë. Kemi lojtarët më të mirë dhe jemi të gjithë të bashkuar. Nuk ka ndarje brenda ekipit. Të gjithë ndihemi të rëndësishëm", ka thënë Oyarzabal.

Spanja është e vetmja kombëtare që ende nuk ka pësuar humbje apo barazuar në "Euro 2024", derisa në raundin e 1/16 e eliminoi Gjeorgjinë me përmbysje 4-1. Në anën tjetër, Gjermania ka barazuar me Zvicrën, derisa e eliminoi me shumë vështirësi Danimarkën (2-0). Për këtë ndeshje ka folur edhe mesfushori Toni Kroos, i cili është i bindur se e premija nuk do të jetë ndeshja e tij



e fundit si futbollist profesionist. Ish-ylli i Real Madridit do të tërhiqet pas "Euro 2024". "Nuk pres që e premija të jetë ndeshja ime e fundit. Ka pasur shumë dyshime para turneut. Ne kemi arritur një objektiv të caktuar minimal. Pavarësisht se çfarë do të ndodhë më pas, nuk do të flitet më për një katastrofë të mëvonshme. Megjithatë, ne i kemi vënë vetes synimin për ta fituar turneun. Kjo është pikërisht ajo ku ne donim të shkonim. Por motivimi është ende për të bërë

progres të madh. Unë jam i vetëdijshëm se nuk do të luaj më futboll pas turneut. Por është ndryshe ta përjetosh momentin. Megjithatë, nuk kam frikë", ka thënë Kroos. Fituesi i kësaj ndeshjeje do të përballet me fituesin e ndeshjes në mes të Portugalisë dhe Francës, e cila zhvillohet sonte (e premte) nga ora 21:00. Portugalia në 1/16 e finales e mposhti Slloveninë vetëm pas ekzekutimit të penalltive, kurse Franca e eliminoi Belgjikën, pasi e mposhti me rezultat 1-0.

FORMACIONET E MUNDSHME: SPANJË - GJERMANI

Spanja: Simon; Carvajal, Le Normand, Laporte, Cucurella; Pedri, Rodri, Ruiz; Yamal, Morata, Williams.
Gjermania: Neuer; Kimmich, Tah, Rudiger, Raum; Kroos, Andrich; Musiala, Gundogan, Wirtz; Havertz.

FORMACIONET E MUNDSHME: PORTUGALI - FRANCË

Portugalia: Costa; Cancelo, Dias, Pepe, Mendes; Palhinha, Vitorino; Silva, Fernandes, Leao; Ronaldo.
Franca: Maignan; Koude, Saliba, Upamecano, Hernandez; Kante, Tchouameni; Dembele, Griezmann, Mbappe; Kolo Muani.

Faruk Statovci emërohet trajner i Flamurtarit

PRISHTINË, 4 KORRIK - Flamurtari është bërë me trajner të ri. Pas largimit të Liridon Lecit, klubi nga kryeqyteti ka njoftuar për angazhimin e Faruk Statovcit shëf i shtabit teknik. Statovci vjen pas aventurës së hidhur në edicionin e kaluar me klubin e Phoenixit në Ligën e Parë, me të

cilin e mbylli sezonin në pozitën e fundit. E klubi i Flamurtarit e njoftoi emërimin e Statovcit përmes një postimi në "Facebook", ku edhe njoftoi se në fillim të javës së ardhshme nis faza përgatitore. "Klubi i Futbollit Flamurtari komunikoi arritjen e

bashkëpunimit me Faruk Statovcin për sezonin vijues. Emërimi i Statovcit si shëf i shtabit teknik vjen si proces i nisjes së projektit për rikthimin e klubit në nivelet më të larta sportive dhe puna e suksesshme ndër vite është vlerësuesi më i mirë për teknikun Statovci.

Fillimi i fazës përgatitore në fillim të javës që po vjen shënon edhe fillimin e etapës së Statovcit në klub. Të gjithë në KF Flamurtari i urojnë mirëseardhje Statovcit dhe stafit të tij, duke u dëshiruar shumë suksese", thuhet në njoftimin e Flamurtarit.



Dellova transferohet te CSKA Sofia, Ballkani: Faleminderit gjigant!

SUHAREKË, 4 KORRIK - Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Lumbardh Dellova, nga Ballkani është transferuar në skuadrën bullgare CSKA Sofia. FC Ballkani e ka falënderuar mbrojtësin për kontributin dhe sukseset historike që i arritën së bashku. "Sulmuesit kundërshtar ishin të trembur

para madhështisë së tij. Hapësirat e zonave që zotëronte në fushë sikur e kishin pronarin e tyre, i cili dominonte në çdo pëllëmbë. Me kualitetin e tij fantastik ai i bëri për vete edhe tifozët kundërshtarë, kurse për FC Ballkanin dhe 'Xhebrailat' dha gjithçka nga vetja, që

bashkërisht t'i arrijmë sukseset tona historike. Të dashur tifozë, pas shqyrtimit të disa ofertave, klubi ka arritur marrëveshje me CSKA Sofian, që ylli ynë dhe i Kombëtares së Kosovës ta vazhdojë karrierën tek 31 herë kampioni i Bullgarisë. Të gjithë jemi mirënjohës për kontributin e

jashtëzakonshëm të qendërmbrojtësit tonë, të cilit i dëshirojmë suksese në vazhdim të rrugëtimit të tij, kurse FC Ballkani gjithmonë do të mbetet shtëpia e Lumbardhit. Faleminderit gjigant!", thuhet në njoftimin e Ballkanit. 25-vjeçari nga Krusha e Madhe



është, po ashtu, përfaqësues i kombëtares së Kosovës, për të cilën është paraqitur në tetë ndeshje.

Pse është i rëndësishëm procesi i licencimit të klubeve pranë FBK-së?

Prishtinë, 4 korrik - Plotësimi i kriterëve për licencim dhe garim nga klubet pranë Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) është një proces esencial që siguron një mjedis të qëndrueshëm, të sigurt dhe të drejtë për të gjithë aktorët e përfshirë në basketbollin e Kosovës. Ky proces ndihmon në ngritjen e nivelit të lojës, zhvillimin e talenteve të reja dhe në promovimin e sportit në përgjithësi. Për këtë arsye Federata e Basketbollit të Kosovës, me ndihmën nga Federata Ndërkombëtare e Basketbollit (FIBA), nga viti 2021 ka nisur zbatimin e kriterëve për licencim dhe garim për klubet e basketbollit. Njëherësh procesi i licencimit të klubeve për garim është pjesë e Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025, me saktësisht të njërit nga pesë qëllimet: Fuqizimi i Klubeve. Federata e Basketbollit të Kosovës nga java e dytë e muajit korrik do ta nisë punën në procesin e licencimit të klubeve për garim në edicionin 2024/25. Kriteret për licencim të klubeve pranë FBK-së janë të rëndësishme për disa arsye kryesore:

aspektet e infrastrukturës, pajisjeve, stafit trajnues dhe menaxhimit të klubit.

Përmirësimi i nivelit të lojës

Kriteret e licencimit ndihmojnë në rritjen e cilësisë së lojës dhe konkurrencës në ligë. Klubet që përbushin këto kriteret zakonisht kanë përgatitje më të mirë, pajisje më të mira dhe menaxhim më të mirë, çka kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm të basketbollit në vendin tonë.

Siguria dhe mirëqenia e lojtarëve


Një nga aspektet e rëndësishme të licencimit është siguria që klubet ofrojnë kushte të përshtatshme për lojtarët e tyre, përfshirë kujdesin shëndetësor, kushtet e stërvitjes dhe trajtimin e drejtë.

Transparenca dhe llogaridhënia

Procesi i licencimit nxit transparencën dhe llogaridhënien brenda klubeve. Klubet duhet të ofrojnë informacione të qarta dhe të sakta rreth strukturës së tyre financiare dhe operacionale, duke siguruar kështu një menaxhim më të përgjegjshëm.

Sigurimi i standardeve të larta

Licencimi siguron që të gjitha klubet t'i përbushin standardet minimale të cilësisë dhe profesionalizmit të përcaktuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës. Kjo përfshin



Zhvillimi i të rinjve

Kriteret përfshijnë edhe zhvillimin e programeve për të rinjtë, duke siguruar që klubet të investojnë në talente të reja dhe të krijojnë një bazë të fortë për të ardhmen e basketbollit në Kosovë.

Integrimi në garat ndërkombëtare

Klubet që përbushin kriteret e licencimit kanë më shumë mundësi për të marrë pjesë në garat ndërkombëtare, pasi ato janë në përputhje me standardet e kërkuara nga organizatat ndërkombëtare të basketbollit.

Rritja e besimit të publikut dhe sponsorëve

Klubet që janë të licencuara krijojnë një imazh më të mirë në publik edhe të sponsorët, duke rritur kështu mundësitë për mbështetje financiare dhe bashkëpunime të ndryshme.

SHKURT

Gjoha nga tifozët në Evropian, Shqipëria e dyta pas kroatëve

Kampionati Evropian ka mbërritur në fazën çerekfinale, por shumë ndeshje janë luajtur deri tani. Normalisht që çdo stadium ka qenë i mbushur me tifozë të kombëtareve të ndryshme, ashtu siç u mbush edhe me shqiptarë në tri ndeshjet e zhvilluara. Duke u përpjekur për të dhuruar spektakël, tifozët e kanë tepruar në disa momente edhe me hedhje sendesh në fushë, apo ndezje flakadanësh apo futje të personave në fushën e lojës. Normalisht këto incidente kanë një penalizim me gjobë nga UEFA dhe, sipas një llogaritje, deri kur ka mbaruar faza e grupeve, Kombëtarja shqiptare është e dyta nga gjohat e marra nga institucioni i futbollit. Sjellja jokorrekte, por jo e tepruar e tifozëve shqiptarë në të tria ndeshjet, ka sjellë gjobë në vlerë 171 375 mijë euro për Federatën Shqiptare të Futbollit. Rekordin nga kombëtares e mban Kroacia e cila është gjobitur në total 220 875 mijë euro. Kroatët luajtën me Spanjën, Shqipërinë dhe Italinë, ndërkohë sjellja e tifozëve ka kapur shifrën më të lartë nga kombëtares. E treta është Serbia, me 166 625 mijë euro. Ajo luajti me Anglinë, Slloveninë dhe Danimarkën. Ndërkohë, pjesa tjetër ka një shifër nën 100 mijë euro ku renditen Turqia, Zvicra, Rumania, Hungaria, Austria, Polonia, Sllovenia, Gjeorgjia, Italia, Gjermania, Ukraina, Holanda, Belgjika, Portugalia, Anglia, Danimarka. Poshtë 10 mijë eurove janë Skocia dhe Çekia, ndërsa ka edhe tri kombëtare, tifozët e të cilave nuk kanë bërë asnjë shkelje që përkthehet në asnjë gjobë. Franca, Spanja dhe Sllovakia janë dy kombëtares që nuk janë gjobitur. Sakaq, nga gjobat UEFA ka arritur të grumbullojë afërsisht 1.3 milion euro.

Zielinski, lojtar i ri i Interit


Piotr Zielinski është përforcimi i fundit i Interit për sezonin e ardhshëm. Megjithatë, konfirmimi i mesfushorit polak nuk është bërë nga kampionët e Italisë, por nga faqja e Serisë A, në të cilën ka dalë njoftimi për depozitim të kontratës së lojtarit. Në moshën 30-vjeçare Zielinski arrin si transferim i lirë tek Interi pas tetë sezonesh me Napolin, klub për të cilin sezonin e kaluar luajti 35 ndeshje në të cilat shënoi katër gola dhe asistoi dy të tjera. Para Napolit, mesfushori polak ka përfaqësuar edhe Empolin dhe Udinesen.

Bayerni transferon Palhinhan

Bayern Muncheni duket se ka kryer goditjen e radhës në merkato, me klubin gjerman që ka transferuar Joao Palhinha. Mesfushori portugez do të firmosë një kontratë katërvjeçare me rekordmenët e Gjermanisë, gjë që do të ndodhë menjëherë pas përfundimit të Evropianit. Ky operacion i kushtoi Bayernit plot 50 milionë euro plus 5 të tjera që do të jenë bonuse, të cilat do të shkojnë menjëherë në arkat e Fulhamit. Palhinha ishte një dëshirë e vjetër e drejtuesve, të cilët e kërkonin atë që në kohën e Tuchelit, teksa tashmë po përgatisin një skuadër të re për Vincent Kompany.

Verstappeni: Në Austri bëmë disa gabime, duam fitoren në Silverstone

VJENË, 4 KORRIK - Pas polemikave dhe tensioneve të përjetuara në garën e fundit të Formula 1, zhvilluar në Austri, me aksidentin e diskutueshëm ku ai ishte protagonist së bashku me Lando Norris, piloti holandez Max Verstappen është gati ta kthejë faqen dhe të fokusohet në garën e radhës në Silverstone. Duke paraqitur garën e së dielës, e treta në tri javë radhazi, tri herë kampioni i botës në Formula 1, hodhi poshtë përplasjen me Lando Norris. Piloti i Red Bullit përsëriti dëshirën e tij për t'u rikthyer te suksesi pas një fundjave të karakterizuar nga "disa gabime".



"Austria nuk solli rezultatin që shpresonim dhe kishte shumë aspekte për të analizuar dhe përmirësuar", ka shpjeguar Verstappen. "Kishte disa gabime që na kushtuan shumë, por ne duhet t'i

shohim momentet pozitive që patëm gjatë fundjavës, duke përfshirë fitoren në garën sprint. Ne po analizojmë atë që bëmë mirë dhe çfarë shkoj keq dhe tani do ta kemi garën e fundit të një tresheje garash shumë sfiduese, kështu që duam t'i rikthehemi fitores në Silverstone", u shpreh Verstappen. "Do të jetë një garë e veçantë dhe do të kemi një pamje të jashtëme të re, të personalizuar në makinë. Ne duam të kthehemi më të fortë dhe jemi gati për fundjavën, sepse është viti i 20 i ekzistencës së ekipit dhe për ne përfaqëson një moment festimi", ka deklaruar piloti holandez.

Wimbledon: Sinner e Alcaraz avancojnë në raundin e tretë, eliminohen Ruud e Osaka

Kanë nisur takimet e raundit të dytë në grand slam-in e Wimbledonit. Numri 1 në botë për meshkuj, italiani Jannik Sinner, fitoi 3-1 ndaj patriotit të tij Matteo Berrettini, duke avancuar më tej pas 4 orësh lojë. Nuk

zhgënjen as spanjollin Carlos Alcaraz, numri 2 në botë, që mundi 3-0 Aleksandar Vukiqin. Një biletë për në raundin tjetër siguron edhe rusi Daniil Medvedev, ndërkohë që është kualifikuar edhe italianin Fabio

Fognini, që mundi 3-1 norvegjezin Casper Ruud, numri 6 në botë. Fitojnë edhe rusi Karen Khachanov, francezi Frances Tiafoe, amerikanin Tommy Paul e spanjollin Robertobautista Agut. Te

femrat, numri 3 në botë, tenistja amerikane Cori Gauff, mundi 2-0 Anca Todoni dhe avancoi më tej. 2-1 fiton tenistja ukrainase Elina Svitolina, ndërsa ajo amerikane Danielle Collins mundi 2-0 Clara Tauson. Në raundin e tretë shkon

edhe tenistja britanike Emma Raducanu, ndërkohë që u eliminua tenistja amerikane Sloane Stephens. Ka mbyllur rrugëtimitin e saj edhe japonezja Naomi Osaka, ndërkohë që avancoi Jasmine Paolini e Italisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 04.07.2024 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike

T-24-9

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e objektit Halla e lëndës së parë Fosfate (H1) në Njësinë Biznesore Industria Kimike
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

1. Njësia Biznesore Industria Kimike

1. Çmimi fillestar

Njësia Biznesore Industria Kimike						
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m ²)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Halla e lëndës së parë - Fosfate (H1)	5,400.00	0.380	0.068	0.448	2,419.20

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes: 04.07.2024
Sqarimi: deri me 20.07.2024
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 20.07.2024
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)
Afati i fundit i dorëzimit: 20.07.2024 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1

OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e qerasë për sipërfaqen e mbuluar		
a	Sipërfaqe e pa mbuluar m ²	
b	Çmimi për meter katrorë m ² në (€) pa TVSH	
c=b*18%	TVSH e çmimit për meter katrorë m ² në (€)	
d=b+c	Çmimi për meter katrorë m ² në (€) me TVSH	
e=a*d	Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)	
e=c+d	Për pagesë në (€)	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 20.07.2024 deri në orën 11.00 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

Aneksi 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E OBJEKTIT

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

